

Data 01.08.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**Objekti i prokurimit:** “Blerje beton i gatshëm”

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV):**

**Vlera e fondit limit:** 2 500 000 *(dy milion e pesëqind mijë) lekë pa tvsh.*

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

*b) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**1.1.1.** Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të viteve 2021, 2022 dhe 2023, lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo më të vogël se vlera e parshikuar e kontratës. Në zbatim të nenit 43, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar mësipër. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

**1.1.2.** Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2021, 2022 dhe 2023 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

**1.1.3.** Operatorët ekonomikë duhet të kenë shlyer të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kesti për periudhën përkatëse të maturuar, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit. Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara përparaqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” (i ndryshuar).

## **2.2 Kapaciteti teknik**

**Për sa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori/t Ekonomik duhet të përmbushë/in kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit të kësaj kontrate. Për të provuar përvojën e mëparshme, duhet që:

a. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten vërtetim i realizimit me sukses dhe faturën tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi për përvojën e mëparshme të paraqiten fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të emallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 39 pika 5. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar me sukses kontratën. Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar ne Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj eshte hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.*

**2.3.3** Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizimin me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, për të përmbushur këtë, Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet te provojne se janë ne gjendje apo kane te garantuar furnizimin e produkteve , per sa mesiper duhet te paraqese dokumentacionin per: 1 (nje) Fabrike betoni me QKL ne Pronesi / kontrate noteriale qeraje / kontrate noteriale furnizimi. Fabrika e betonit duhet te jete e pajisur me Leje Mjedisi tipi A ,Kodi : III.1.A. dhe Leje Mjedisi tipi B , Kodi:III.1.B. Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me licensen Kodi:III.2.B

Në rastin kur, operatorët ekonomikë kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të

paraqitet gjithashtu edhe kontrata e vlefshme e qirasë apo e furnizimit (kjo kontrate duhet te jete e vlefshme per periudhen e realizimit te kontrates se furnizimit).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.



Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 35 (tridhjetë e pesë ) persona në total gjate tre muajve te fundit nga momenti i shpalljes se procedures .**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

**Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

**2.3.4** Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se mallrat, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.
2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit) /ekuivalente dhe e vlefshme.
3. ISO 45001 ( Standard për menaxhimin e rrezeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë) /ekuivalente dhe e vlefshme.

**Argumentim:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se:

*“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP([www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)).

## **Njësia e Prokurimit**



